

VENDIM
Nr. 169, datë 7.11.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “KROI MBRET ENERGI” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pika 1, 3 dhe 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 101/1 prot., datë 31.10.2019, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “KROI MBRET ENERGI” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “KROI MBRET ENERGI” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 634 prot., datë 11.10.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Kjo shoqëri është regjistruar në datën 20.7.2012 pranë QKB-së, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, dhe mban numër identifikimi (NUIS) L29326401S. Shoqëria “KROI MBRET ENERGI” sh.p.k., përfaqësohet nga administratorja znj. Flutura Ismaili dhe kapitali zotërohet nga ortaku i vetëm: “Alba Konstruksion” sh.p.k.

- Objekti i veprimtarisë së saj është: “Ndërtim-operimi dhe transferimi i hidrocentraleve: ‘Backa 1’, ‘Backa 2’, ‘Backa A’, ‘Backa B’, ‘Backa C’, tek Autoriteti Kontraktues ku përfshihet financimi, ndërtimi, vënia në punë, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë elektrike në zbatim të Kontratës Koncesionare nr. 1616 rep., nr. 374 kol., datë 26.6.2012”.

- Aplikimi i shoqërisë “KROI MBRET ENERGI” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE-ja në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat: “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d” “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar pjesërisht;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht;

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, (neni 9, pika 4.8, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht.

Në lidhje me mungesën apo plotësimin e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor: neni 9, pika 2, germa “e” (struktura e ndërtimit të shoqërisë, lista e personelit sipas profilit, në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca);

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal: neni 9, pika 3, germa “b” (bilanci financiar për vitet 2016 dhe 2017);

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike: neni 9, pika 4.8:

germa “a” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në GWh/sipas viteve);
germa “b” (evidentimi i të ardhurave që do të përdoren për qëllime të veprimtarisë së licencuar).

Do të njoftohet aplikuesi që në bazë të nenit 10, pika 9 dhe nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “KROI MBRET ENERGJI” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti